



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6584/2025

A.nr.1481/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1481/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesi, Sh.Sh, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1481/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesi, Sh.Sh.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, Sh.Sh.(në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 25.07.2025 përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017340, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i lartë, gjegjësisht, për pozitën e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Prishtinë, të shpallur nga Inspektorati i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.08.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.09.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1481/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 21.03.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00017340, Për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i lartë, respektivisht për pozitën e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë” në Rajonin e Prishtinës, me klasë të pozitës Profesional 1, nëntë (9) vende të lira pune, i hapur për aplikim nga data 22.03.2025 deri më datën 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs dhe se i njëjti ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i`u nënshtruar vlerësimit profesional. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 10.07.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me (18) kandidatë të suksesshëm.

Pas publikimit të Njoftimit të datës 10.07.2025, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj procedure. Shton se nuk është bërë vlerësim i duhur i testit me shkrim, nga ana e Komisionit të Vlerësimit, më theks të veçantë i eses, gjithashtu, pretendon se përbërja e Komisionit të pranimit është e kundërligjshme dhe është formuar nga personi pa autorizim ligjor. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procesin e rekrutimit në tërësi.

Duke qenë se kandidati Nderim Gashi, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00017340.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1481/2025, të datës 25.07.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këtë procedurë, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1481/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1481/2025, të datës 25.07.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1481/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Sh.Sh;
- Njesisë se Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.